



REPUBLIKA E SHQIPERISË

ZYRA E NOTERISË DURRËS

NR. 3 Rep.

NR. 5 Kol.

**KONTRATË SHITESË KONCESIONI
PËR DISA NDRYSHIME NË KONTRATËN E KONCESIONIT TË
FORMËS “BOT” PËR NDËRTIMIN E HIDROCENTRALEVE
”ARREZ”, “SHENDELLI”, “SOTIRE”, “PODE”, “MESARE”,
”URA”, “RAJAN 2”, “PODE”, “RADON”, “PODE”, “DEDOVE”,
”PESHTAN”, “OSNATI” DHE “GRADISHT”,**

Në Tiranë, më datë 11, muaji Juani, viti 2013 (dyzetë e tre mijë e dhjetë),
para meje noter _____, anëtar i dhomës së Noterisë DURRËS, me
adresë _____, u paraqitën palët kontraktuese si më poshtë:

Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, në cilësinë e Autoritetit
Kontraktues, përfaqësuar nga z. Edmond Haxhinasto, i datëlindjes
madhor dhe me zotësi juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u sigurova nga
.....

DHE

Shoqëria koncesionare “Rajan Energy” sh.p.k., e cila figuron e rregjistruar si person
juridik ne QKR me NIPT L01630010E dhe date 30.04.2010, përfaqësuar nga z. Carlo
Francione, i datëlindjes _____, madhor dhe me zotësi juridike për të vepruar, për
identitetin e të cilit u sigurova nga Pasaporta nr. _____.

Palët me vullnetin e tyre të lirë, bien dakord si më poshtë:

Të lidhin këtë Kontratë Shtesë koncesioni, si pjesë përbërëse e Kontratës së koncesionit
të formës BOT, të nënshkruar nga palët Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës
dhe Bashkimit të Shoqërive “IMET” spa & “Advisor C. Energy” sh.p.k., për ndërtimin e
hidrocentraleve “Arrez”, “Shendelli”, “Sotire”, “Pode”, “Mesare”, “Ura”, “Rajan 2”,
“Pode”, “Radon” “Pode”, “Dedove”, “Peshtan”, “Osnati” dhe “Gradisht”, nënshkruar
dhe hyre e fuqi date 26 Qershor 2009.

Hyrje

Duke pasur parasysh që:

- Në VKM nr. 448, datë 16.06.2010 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr. 27, datë 19.01.2007, të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullave të vlerësimit dhe të dhënies së koncesioneve", të ndryshuar dhe akteve në zbatim të tij" është parashikuar se "...Autoriteti Kontraktor, në bazë të një vlerësimi, mund të japë një afat deri në 12 muaj, për kontratat e ndërtimit të hidrocentraleve me koncesion me kapacitet deri në 5 MW, deri 18 muaj, për kontratat e ndërtimit të hidrocentraleve me koncesion me kapacitet nga 5 deri 20 MË dhe deri në 24 muaj, për kontratat e ndërtimit të hidrocentraleve me koncesion mbi 20 MW, për marrje lejeje dhe përgatitje projekti" dhe "...Të gjitha shoqëritë koncesionare, të cilat, deri në hyrjen të fuqit të këtij vendimi, nuk e kanë parashikuar afatin e nevojshëm të marrjes së këtyre lejeve në kontratat koncesionare përkatëse, kanë të drejtë të shtyjnë afatin.....
.... Shtyrja e afatit të pasqyrohet, për çdo rast, në kontratat shtesë të palëve në koncesion. Ministri përgjegjës i miraton këto kontrata, të cilat hyjnë në fuqi me firmosjen e saj nga palët."
- në nenin 10.2 është parashikuar afati 12 muaj për marrjen e lejeve. (24 muaj ne total – 12 muaj ndërtim ne grafikun e punimeve, pika 5 (b), e Udhëzimit).
- Referuar Pikës 7, të Udhëzimit Nr.873, datë 13.12.2010 "Për përcaktimin e kriterëve për shtyrjen e afateve të përgatitjes së projekteve të zbatimit dhe marrjes së lejeve në kontratat koncesionare të miratuara", koncesionari ka të drejtë të përfitojë 6 muaj shtesë afati për vënien në shfrytëzim të hidrocentralit "Arrez", "Shendelli", "Sotire", "Pode", "Mesare", "Ura", "Rajan 2", "Pode", "Radon", "Pode", "Dedove", "Peshtan", "Osnati" dhe "Gradisht".
- Bazuar ne nenin 10, pika 3 e kontrates se koncesionit ku përcaktohet se: "... Keto afate do të ndryshohen ne marreveshje midis Autoritetit Kontraktues dhe Koncesionarit, nese marrja e lejeve eshte vonuar pertej kohes se rregullt proceduriale per marrjen e tyre." dhe duke qene se nga Agjencinë Kombëtare e Burimeve Natyrore ka pasur nje vonese prej 20 muajsh, koncesionari ka të drejtë të përfitojë 20 muaj shtesë afati për vënien në shfrytëzim të hidrocentraleve "Arrez", "Shendelli", "Sotire", "Pode", "Mesare", "Ura", "Rajan 2", "Pode", "Radon", "Pode", "Dedove", "Peshtan", "Osnati" dhe "Gradisht".
- Ne total koncesionari ka të drejtë të përfitojë 26 muaj shtesë afati për vënien në shfrytëzim të hidrocentraleve "Arrez", "Shendelli", "Sotire", "Pode", "Mesare", "Ura", "Rajan 2", "Pode", "Radon", "Pode", "Dedove", "Peshtan", "Osnati" dhe "Gradisht".

Në Kontratën e koncesionit të formës BOT për ndërtimin e hidrocentraleve "Arrez", "Shendelli", "Sot re", "Pode", "Mesare", "Ura", "Rajan 2", "Pode", "Radon", "Pode", "Dedove", "Pesh an", "Osnati" dhe "Gradisht", nënshkruar dhe hyre në fuqi date 26 Qershor 2009, të bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Në nenin 10. "Programi i punimeve":

Pika 2. zëvendësohet me paragrafin si më poshtë:

"Koncesionari merr përsipër të vërë në punë hidrocentralin brenda 50 (pesëdhjetë) muajve nga hyrja në fuqi e kontratës së koncesionit. Afati i ndërtimit është 12 muaj si e parashikuar në grafikun e punimeve të paraqitur në Aneksin 2. "

Neni 2

Kjo kontratë shtesë koncesioni hyn në fuqi me nënshkrimin e saj nga palët.

Kontrata shtesë e koncesionit u hartua në 3 (tri) kopje, në gjuhën shqipe, dhe pasi u lexua palëve, të cilët e kuptuan dhe e pranuan atë e nënshkruan me vullnet të lirë e të plotë dhe une noteria e vërtetoj atë rregullisht sipas ligjit.

PALËT

AUTORITETI KONTRAKTUES

Ministria e Ekonomisë, Tregtisë
dhe Energjetikës

Përfaqësuar nga :

z. Edmond Haxhinasto



SHOQËRIA KONCESIONARE

"Rajan Energy" sh.p.k.

Përfaqësuar nga :

z. Carlo Francioni

